Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.16/2020, në orën 13:00, salla N 302

Prishtinë, më 24 shtator 2020

P R O C E SV E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Besa Ismaili-Ahmeti, Zikreta Aliti, Saranda Musliu, Saranda Bogujevci, Fjolla Ujkani, Valdete Idrizi dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Jasmina Dediq dhe Marigona Geci.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Edi Gusia-ABGJ-ZKM, Leonora Selmani-ABGJ-ZKM, Alisa Thaçi-Kuvendi i Kosovës, Falkona Kosoumi-GP LDK, Hasan Hoti-Ekonomia Online, dhe Visar Morina-OSCE Consulent, Arianit Behrami-Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje**

Duda Balje, kryetare, njoftoi se pas debatit që kishin në mbledhjen e datës 23 shtator 2020, sot për të pasur një konsultë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, e kemi të pranishme, znj.Edi Gusia, kryeshefe e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe znj.Leonora Selmani, udhëheqëse e Divizionit për legjislacion në këtë Agjenci.
Ne si komision funksional, jemi të gatshëm të procedojmë me draftin e këtij projektligji sepse ekziston një punë e mirë që është bërë nga mandati i kaluar.

Edi Gusia, tha se se vitin e kaluar i janë bashkangjitur nismës së komisionit për amendamentimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje. Ka qenë një proces që ka zgjatur deri në shtator të vitit 2019, që kemi punuar në një draft ligj, ndërkohë kanë ndodhur ndryshimet politike dhe në dhjetor të vitit 2019, ne nuk kemi arritur që atë draft ligj ta procedojmë në Qeveri për miratim sepse fillimisht nuk ka qenë draft i finalizuar dhe në konsultim me Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit, kur është vërtetuar se ai draft ligj në të cilin ne kemi bashkëpunuar, realisht tejkalon 50% e amendamentimit, në atë moment ai duhet të konsiderohet se është ligj i ri.

Draftin që e kemi punuar bashkërisht besoj se është ndryshuar përafërsisht 70%, në të mirën e integrimit dhe përfshirjes së kërkesave të Konventës së Stambollit, për të cilin ju rregullisht keni shprehur gatishmërinë që parimet e kësaj konvente t'i integrojmë në Ligjin e ri të amendamentuar. Ajo me tej sqaroi procedurat se si bëhet një ligj në Qeveri sepse procedurat kanë ndryshuar dhe prej vitit 2016, fillimisht duhet bërë një koncept dokument. Për këtë kemi themeluar grupin e punës dhe në shkurt të vitit 2020, kemi filluar me përgatitjet e grupit të punës, por për shkak të pandemisë nuk kemi arritur ta mbledhim deri më tani grupin e punës. Fjala e plotë e saj ekziston e incizuar në administratën e Komisionit.

Kryetarja, tha se komisioni pati një takim dje, ku ka diskutuar lidhur me këtë projektligj dhe se situata në terren, sa i përket rritjes së rasteve të dhunës në familje është jo e mirë. Andaj kemi nevojë që të bëhet një ligj i mirë për një kohë më të shkurtër dhe si komision kemi marrë vendim që draftin që kemi punuar në legjislaturën e kaluar, ta procedojmë dhe ta punojmë më tej, si nismë ligjore të komisionit.

Teuta Haxhiu, tha se kohëve të fundit vërehet një ngritje e zërit nga shoqëria civile, e cila kërkon që institucionet të bëjnë maksimumin për rastet e dhunës në familje e që fatkeqësisht nuk janë të pakta.
Ne si komision përkatës, fatmirësisht kemi pasur një nismë dhe jam interesuar për hapat e mëtejme që mund ti bëjë komisioni.
Mosfinalizimi në disa nene ka qenë pikërisht për shkak se ne tentuam ta bëjmë një vizitë studimore, dhe nuk kemi mundur ta definojmë plotësisht dhe për këtë mendoj se nuk është ndonjë problem, ngase një gjë e tillë mund të bëhet edhe në fazën e amendamentimit.

Saranda Bogujevci, tha se në koncept dokumentin që e keni punuar si Qeveri, a ka elemente që ne nuk i kemi përfshi në këtë draft.
Kemi kërkuar që Konventa e Stambollit të jetë pjesë e Kushtetutës dhe kjo kërkon edhe plotësim- ndryshimin e shumë ligjeve të tjera dhe po me intereson se me këtë koncept dokument a është bërë edhe një analize rreth çështjes së Konventës së Stambollit.
Është e vërtetë se rruga më shkurtër që të procedohet projektligji është përmes komisionit, por është me rendësi që të kemi një draft sa më të kompletuar dhe të punojmë bashkërisht.

Fjolla Ujkani, pyeti se gjatë kësaj periudhe kohore nga 2 dhjetori i vitit 2019, jeni marrë me intensitet me këtë çështje dhe deri tani cilat sugjerime dhe rekomandime keni parë se duhet të përfshihen në këtë draft, sepse ju jeni edhe institucion për barazi gjinore, ndërsa ne jemi të fushave të ndryshme dhe si komision nuk e kemi vetëm këtë çështje që duhet ta trajtojmë, por shumë punë të ndryshme, kështu që na duhet edhe ana profesionale e juaj.

Edi Gusia, si Agjenci, shprehim gatishmërinë dhe kemi nderin e veçantë nëse na bashkoheni komplet si komision në grupin punues, për hartimin e koncept dokumentit.
Problemin që e kemi hasur në terren, së paku prej analizës që e kemi bërë tek procedurat standarde të veprimit, nuk ka të bëjë me legjislacionin, ka të bëjë me mosllogaridhënien individuale të institucioneve të caktuara, në momentet kur i trajtojnë rastet e dhunës në familje, qofshin ato gjyqësori, mbrojtësit e viktimave, policia por edhe vet strehimoret.
Kemi vërejtur se sektori i punëtorëve socialë në përgjithësi në nivel të vendit, ballafaqohen me probleme të natyrës së punës, nuk kanë hapësira të mjaftueshme të punës, nuk kanë makina, jo rrallë ndodh që policët e trafikut janë ata të parët që mund të ndodhen më afër rastit, ku ndodh dhuna dhe ndoshta një polic i pa trajnuar është në situatë, kur duhet të shkojë dhe të ofrojë ndihmën.
Ajo që mbetet shumë për të dëshiruar, është çështja e gjyqësorit, do të thotë se si ata e shohin fenomenin e dhunës në familje dhe mostrajtimi adekuat i recidivizmit të cilët lihen me

dënime shumë të buta, dhe përfundojnë me raste shumë ekstreme. Ligji duhet të jetë ligj për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe në baza gjinore.
Çështja e strehimoreve, janë ballafaquar ndër vite me mungesë të mjeteve financiare, strehimoret që i trajtojnë rastet e dhunës në familje prej vitit 2016 deri në vitin 2020, janë financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në vlerë prej 1.5 milion euro, që i bie se Qeveria e ka tejkaluar vetveten prej 350% prej asaj çka ka paraparë në strategji.

Besa Ismaili-Ahmeti, lidhur me konventën e Stambollit, pyeti pse ka aq dyshime nga Agjenciai, sepse edhe shtetet e rajonit, së paku në aspektin social, nuk mendoj se janë më mirë se Kosova, por që e kanë të ratifikuar këtë konventë, pse aq shume dyshime në ratifikimin në Kosove dhe përshtatjes se ligjeve tona.

Edi Gusia, tha se ligji i ri do të duhej me i inkorporuar të gjitha kërkesat e Konventës së Stambollit, do të thotë që t'i parashohim me legjislacion sepse do të ketë implikime të mëdha buxhetore. Duhet të punohet shumë me institucionet në llogaridhënie dhe transparencë.

Fjolla Ujkani, pyeti nëse Konventa e Stambollit bëhet pjesë e Kushtetutës sonë, a ka mekanizma ndëshkues nëse nuk zbatohet.

Edi Gusia, tha se kjo ka implikime të tjera juridike për zbatimin e Konventës së Stambollit dhe është jashtë kompetencave të saj. Nëse sot ju vendosni që nismën ligjore ta ndërmerrni, duhet të bëni një arsyetim se përse e keni ndërmarrë këtë nismë, sepse ne e kemi vendosur në strategjinë e draft koncepteve dhe takimin e parë e kemi qysh të hënën.

Kryetarja, tha se normalisht, nëse ne vendosim ta procedojmë si komision, ju do të njoftoheni dhe do ta keni arsyetimin me shkrim.

Kryetarja konstatoi se përfundoi takimi konsultativ me përfaqësues të ABGJ-së, dhe i falënderoi ata për bashkëpunimin e deritashëm dhe u zotua se edhe në të ardhmen ky bashkëpunim do të jetë akoma më i shprehur, në veçanti edhe në këtë projektligj**.**

Në fund të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kryetarja e hodhi në votim Nismën ligjore për Projektligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave.

Kryetarja konstatoi se në votim morën pjese 8 anëtarë të komisionit, të cilët votuan "Për".

Më pas, kryetarja konstatoi se Nisma ligjore për Projektligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave, pas kompletimit nga ana e administratës së komisionit me dokumentacionin përcjellës të kërkuar, procedohet për Kryesinë e Kuvendit.

2. Të ndryshme

Kryetarja, tha se ka kërkesë nga Shoqata e Invalidëve të Paraluftës të cilët edhe i kemi takuar me herët.
Në legjislaturën e kaluar e kemi bërë një kërkesë në Qeveri por pastaj shkuam në zgjedhje.

Teuta Haxhiu, njoftoi komisionin se ka më shumë se 5 apo 6 javë që ka filluar një nismë ligjore dhe ka kaluar në Kryesi të Kuvendit. Kjo nismë ligjore ka shkuar në Qeveri për mendim, nismë ligjore për plotësim ndryshimin e ligjit për kategoritë e dala nga lufta,

pikërisht për kërkesën e tyre. Dhe, asaj shoqate, vetëm një njoftim ua dërgon si kryetare se është marrë një nismë ligjore lidhur me kërkesën e tyre.

Teuta Haxhiu, kërkoi që në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për njohjen e statusit të ish- të dënuarve dhe ish- të përndjekurve politikë.

Kryetarja, njoftoi se zëvendëskryeministri, Driton Selmanaj, nuk ka kthyer përgjigje për takim dhe u kërkua që të përsëritet kërkesa edhe një herë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

_____

Duda BALJE